

## **AKT - THEMELIMI**

### **I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TËKUFIZUAR**

**“FVF” Future Value Formula shpk**

Ortaku i vetëm i Shoqërisë “FVF” Future Value Formula shpk

1. Znj. Rozana Plaku, lindur në Roskovec, datë 11/02/1983 dhe banues në Fier, shtetas shqiptar, i identifikuar me leternjoftimin nr.035720242, lëshuar në datë 28.01.2020, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

## **VENDOS**

### **Neni 1**

Të themelojë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar të quajtur:

**“FVF” Future Value Formula shpk**

Shoqëria është një subjekt juridik shqiptar, të cilës i lind e drejta të ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Shoqëria **“FVF” Future Value Formula shpk** “ zhvillon aktivitetin e saj ne përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

### **Neni 2**


Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

### **Neni 3**

**“FVF” Future Value Formula shpk**\_ka selinë e saj në Lagjen 29 Nentori, Rruga Todi Shkurti, Shtepia nr.1 Prane Gjykates, Fier

Shoqëria ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi përfaqësimi, seli sekondare, degë, si dhe ti suprimojë ato. Shoqëria ka gjithashtu të drejtë të krijojë, apo të jetë pjesë e një apo më shumë shoqërive tregtare, pavarësisht nga statusi i tyre juridik, me një pjesëmarrje që do të përcaktohet në çdo rast nga Asambleja e Ortakëve.

### **Neni 4**



Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë **pa afat**. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë në përputhje me dispozitat statutores dhe legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 5**

Kapitali themeltar është tërësisht në para. Të gjitha kuotat e kapitalit themeltar, perkatesisht 100 (njqind) leke, janë tërësisht në para. Rritja e kapitalit të shoqërisë nuk është e kufizuar.

#### **Neni 6**

Objekti i shoqërisë përfshin ofrimin e konsulences në fushën financiare, tregtise, analiza biznesi dhe marketing. Pjesë e veprimtarisë së saj do të jenë edhe tregëtimi dhe shitja e aparaturave elektronike, printime, design, prodhimi i tabelave brail, materiale marketingu, ndërtim dhe ngritje website, si dhe ndërtim dhe zhvillim teknologjie VR për aplikacione të ndryshme, ndertim platform elektronike per telefona celulare IOS dhe Android, krijimi i QR Code te objekteve te ndryshme. Gjithashtu ofrojme sherbime perkthimi nga gjuha italiane dhe angleze, redaktime/ korrektive materialesh studimore.

#### **Neni 7**

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët themelues mbartin rrezikun e veprimtarisë së Shoqërisë në masën e kapitalit të investuar në Shoqëri.


#### **Neni 8**

Organet e shoqërisë "FVF" **Future Value Formula shpk** janë:

- Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.
- Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i shoqërisë do të jetë Znj. Rozana Plaku, lindur në Roskovec, datë 11/02/1983 dhe banues në Fier, shtetas shqiptar, i identifikuar me leternjoftimin nr.035720242, lëshuar në datë 28.01.2020, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili do të ushtrojë dhe mbajë në mënyrë të veçantë kompetencat e administratorit, për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Ky afat mund të ndryshojë lirisht në çdo moment që konsiderohet e nevojshme nga asambleja e ortakëve.



Përveç sa është përcaktuar shprehimisht në statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë, Administratori do të ketë tagra të kryejë veprime bankare në llogarinë e shoqërisë që lidhen me tërheqjen e shumave të depozituara apo çdo veprim tjetër, veprime të cilat mund të kryhen vetëm nga administratori apo person të tjerë të autorizuar enkas me prokurë të posaçme për këtë qëllim. Modalitetet për ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga Statuti i shoqërisë, ligji 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe ligji Nr. 9723 datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ky Akt - Themelimi është përpiluar në dy kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

#### ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"FVF" Future Value Formula shpk

Znj. Rozana Plaku

"FVF" SHPK  
FUTURE VALUE FORMULA

Rozana Plaku

Fier, më

23.02.2021

Rozana Plaku